

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-155/14**

**Prishtinë, 9 Mars 2016**

Në çështjen juridike të:

**V. D. M.**

**Pala ankuese**

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini si kryetar i kolegjit, dhe Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov si anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrat KPA56653 dhe KPA56655), të datës 21 gusht 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 9 Mars 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesat e V.D. M., të regjistruara me numër GSK-KPA-A-155/2014 dhe GSK-KPA-A-156/2014, bashkohen në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-155/2014.
2. Ankesat e V. D. M. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013, të datës 21 gusht 2013, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numër KPA56653 dhe KPA56655, refuzohen si të pabazuara
3. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013, i datës 21 gusht 2013, konfirmohet sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numër KPA56653 dhe KPA56655.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 26 nëntor 2007, V. D. M. (tani e tutje: pala ankuese) në cilësi të anëtarit të familjes së bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore – gjyshit të tij J. P. M., ka paraqitur dy ankesa të ndara në Agjencinë Kosovare të Pronës (tani e tutje: AKP), të regjistruara me numra të lëndës nr.KPA56653 dhe nr. KPA56655, duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës me sipërfaqe të përgjithshme prej 00.42.00 ha dhe të ngastrës me sipërfaqe të përgjithshme prej 00.14.00 ha, të dyja me lokacion në fshatin Zhegër, Komuna e Gjilanit (tani e tutje: prona e kërkuar). Fillimisht pala ankuese nuk ka përmendur numrin e ngastrës se kërkuar kadastrale.
2. Më 13 qershor 2008 pala ankuese bëri të qartë se kërkon ri-posedimin e ngastrave kadastrale nr. 850, 851 (Kërkesa e regjistruar me numër KPA56653) dhe nr.1346, 1347 dhe 1348 (Kërkesa e regjistruar me numër KPA56655).
3. Pala ankuese bashkë me kërkesën ka paraqitur në AKP *ndër tjera*:
  - Certifikatën e lindjes nr.69/1945 të lëshuar nga Komuna e Gjilanit e cila vërteton se pala ankuese është i lindur më 25 prill 1945 nga e ëma Z. M. dhe babai D. M.;

- Certifikatën e vdekjes nr.22/1998 të lëshuar nga Komuna e Gjilanit e cila vërteton se D. M. ka vdekur më 04 nëntor 1998 dhe se prindërit e tij janë J. M. dhe J. M..
  - Certifikatën e vdekjes të lëshuar më 23 janar 2008 nga Komuna e Vrajës, Serbi, e cila vërteton se D. J. M. ka vdekur më 04 nëntor 1998 dhe se fëmijët e tij janë D.P., R.J., M. M. dhe pala ankuese V. M..
  - Aktvendimin nr.12-951-62624 të lëshuar më 11 janar 2012 nga Agjencia Kadastrale e Kosovës e cila e njeh palën ankuese si pronarin e 6 ngastrave kadastrale, asnjëra prej tyre identike me pronën e kërkuar.
  - Aktvendimin nr.12/44932 të lëshuar më 11 tetor 2012 Komuna e Gjilanit, Departamenti për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, e cila pranon kërkesën e palës ankuese për ndarjen e 4 ngastrave kadastrale, asnjëra prej tyre identike me pronën e kërkuar.
  - Kontratën mbi dhuratë të lidhur më 15 qershor 1994 në mes të babait të palës ankuese D. M. si dhuratëdhënës dhe palës ankuese si dhuratëmarrës. Subjekti i kontratës janë 8 ngastra kadastrale, asnjëra prej tyre identike me pronën e kërkuar.
4. AKP-ja ka siguruar *sipas detyrës zyrtare* Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr.893/2008 e cila rendit Stojan Stojanović-in si pronarin e ngastrave kadastrale nr.1346, 1347.
  5. AKP-ja ka siguruar *sipas detyrës zyrtare* Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr.510/2008 e cila rendit B. M., P. P., V. P. dhe D. P.si pronarët e ngastrave kadastrale nr.1348.
  6. Më 31 korrik 2008 dhe 03 nëntor 2008 AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesave. Prona e kërkuar është gjetur e zaptuar nga Bislim Veseli (ngastrat kadastrale nr. 850, 851) dhe nga një person i panjohur (ngastrat kadastrale nr.1346, 1347 dhe 1348). B. V. ka refuzuar ta marrë dhe ta nënshkruajë njoftimin mbi pjesëmarrjen. Më 21 korrik 2010 është bërë njoftimi publik në Gazetën Zyrtare të AKP-së. Askush nuk ka marrë pjesë si palë e paditur në procedurë.
  7. Më 21 gusht 2013, KKPK-ja me vendimin KPCC/D/A/212/2013 ka refuzuar kërkesat me arsyetimin se pala ankuese nuk ka arritur ta vërtetojë pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar.
  8. Më 5 mars 2014, vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese. Më 4 prill 2014, pala ankuese ka paraqitur ankesat.

### **Pretendimet e palës ankuese**

9. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së përmban zbatim të gabuar të ligjit material dhe vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike. Pala ankuese pohon se gjyshi i tij Jovan Pavić ka qenë pronar i pronës së kërkuar dhe se ekziston një keqkuptim sepse mbiemri i gjyshit të tij është i ndryshëm nga mbiemri i tij dhe i babait të tij. Pala ankese kërkon nga Gjykata Supreme që t'ia njoh të drejtën e ri-posedimit të pronës së kërkuar.

### **Arsyetimi ligjor**

#### **Pranueshmëria e ankesave**

10. Ankesat janë paraqitur brenda afatit kohor prej 30 ditësh të përcaktuar me nenin 12.1 të Ligjit Nr. 03/L-079, dhe janë të pranueshme.

#### **Bashkimi i ankesave**

11. Neni 13.4 i rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, përcakton se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkrira kur për bashkimin apo shkrirjen e tillë është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të ligjit. Ky nen i lejon Gjykatës Supreme që të marrë parasysh bashkimin ose shkrirjen e ankesave për të shqyrtuar dhe për të marr aktgjykime kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
12. Dispozitat e Ligjit të procedurës kontestimore të cilat janë të zbatueshme në procedurat pranë Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, si dhe dispozitat e nenit 408.1 në lidhje me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L006 të procedurës kontestimore, përcaktojnë mundësinë e bashkimit të të gjitha kërkesave përmes aktvendimit, nëse me një gjë të tillë do të sigurohej efektiviteti i gjykatës dhe efikasiteti i çështjes.

13. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme ka vërejtur se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën është paraqitur ankesa përkatëse, faktet, baza ligjore dhe çështjet e provave janë tërësisht të njëjta në të dy lëndët. Vetëm parcelat, subjekti i të drejtës pronësore i cili pretendohet në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në të njëjtin dokumentacion. Për më tepër, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjtë.
14. Prandaj, ankesat e regjistruara me numrin GSK-KPA-A-155/14 dhe GSK-KPA-A-156/14 janë bashkuar në një lëndë të vetme nën numrin GSK-KPA-A-155/14.

### **Meritat e ankesës**

15. Pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë provë për pretendimet e tij se gjyshi i tij J. (P.) M. ka pasur të drejta pronësore mbi pronën e kërkuar. Me prezantimin e certifikatave të lindjes dhe të vdekjes ai vetëm ka vërtetuar marrëdhënien e tij me gjyshin. Aktvendimet Nr.12-951-62624 i lëshuar më 11 janar 2012 nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Nr.12/44932 i lëshuar më 11 tetor 2012 nga Komuna e Gjilanit, Departamenti i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, dhe kontrata mbi dhuratën e lidhur më 15 qershor 1994 në mes të babait të palës ankuese D.M. si dhuratëdhënës dhe palës ankuese si dhuratëmarrës kanë të bëjnë me parcelat Kadastrale të cilat nuk janë identike me pronën e kërkuar. AKP-ja sipas detyrës zyrtare ka marrë Certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme Nr.893/2008 dhe Certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme Nr.510/2008 të cilat rendisin persona të tjerë si pronarë të pronës së kërkuar.
16. Rrjedhimisht, KKPK-ja ka pasur të drejtë kur ka refuzuar kërkesat. Nuk është bërë asnjë shkelje e ligjit substancial e as nuk ka pasur vërtetim jo të plotë të fakteve. Prandaj, Gjykata Supreme gjen se ankesat janë të pabazuara.
17. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në bazë të nenit 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë juridike:**

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it**